

Produkti 2.3 - Raport mbi zhvillimin e moduleve të trajnimit

Hartuar nga	<i>Darko Ciglar / ACT Grupa</i> <i>Gregor Cotič / SENT</i>	më	09.11.2022	Versioni nr. 1
Rishikuar nga	<i>Azizam Yussupova / ENSIE</i> <i>Gregor Cotič / SENT</i>	më	10.11.2022	Versioni nr. 2
	<i>Era Sherifaj / Partners Albania</i>	më	17.11.2022	Versioni nr. 3
VERSIONI PËRFUNDIMTAR				
Miratuar nga	<i>Aziza Yussupova / ENSIE</i>	më	21.11.2022	



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISes4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Përmbajtja

I.	Qëllimi i raportit.....	3
II.	Përshkrimi i situatës.....	3
III.	Aspektet teknike të zhvillimit të Kurrikulave	5
IV.	Aspektet e përmbajtjes të zhvillimit të Kurrikulave	10
A.	Struktura e Kurrikulave	10
B.	Përmbajtja / objektivat.....	12
C.	Parimet e përgjithshme të trajnimit.....	13
D.	Rreziqet e mundshme dhe masat zbutëse të trajnimit	14
V.	Analiza dhe vlerësimi i cilësisë së Kurrikulave	16
VI.	Hapat e ardhshëm në zhvillimin/zbatimin e Kurrikulave.....	17
VII.	Të mësuarit nga procesi i zhvillimit të Kurrikulave	18



I. Qëllimi i raportit

Ky dokument paraqet Raportin mbi zhvillimin e moduleve të trajnimit (Dorëzimet 2.1. Kurrikula (për trajnimin e partnerëve) për menaxhimin e sipërmarrjeve sociale dhe WISE-ve (Work Integration Social Enterprise – Sipërmarrje sociale me në fokus integrimin në punë) dhe Dorëzimet 2.2 Kurrikula për menaxhimin dhe matjen e impaktit social (SIMM- Social Impact Management and Measurement).

Ky raport ka si qëllim të shpjegoj arsyetimin e procesit të zhvillimit të të dy moduleve të trajnimit që janë përmendur më lart.

Raporti përmban aspekte teknike të procesit (përshkrimi i procesit, koha, rolet, qasja e përdorur gjatë krijimit) por edhe aspekte të përmbajtjes (Struktura e Kurrikulës, pasqyra e përmbajtjes, parimet e trajnimit, rreziqet...) si dhe mësimet e nxjerra nga procesi.

II. Përshkrimi i situatës

Sipërmarrja e të rinjve në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk ka zhvillim të mjaftueshëm dhe as mbështetje për sa i përket programeve arsimore cilësore, prezencës së programeve në strukturat mbështetëse të biznesit/ekonomisë sociale, prezencës dhe disponueshmërisë së burimeve dhe instrumenteve financiare për testimin e ideve të reja.¹

Objektivi i përgjithshëm i projektit WISEs4Youth është të zhvillojë aktivitete trajnimi për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse sociale, me synim sipërmarrësit e rinj socialë të mundshëm në Ballkanin Perëndimor. Në mënyrë që të kontribuohet për këtë objektiv dhe qëllim, një nga aktivitetet kryesore dhe dorëzimet janë dy Kurrikulat:

- Dorëzimet 2.1. - Kurrikula (për trajnimin e partnerëve) për menaxhimin e sipërmarrjeve sociale dhe WISE-ve dhe

¹

1.1 Think Thank për Studentin Evropian, 2022., Sipërmarrja e të rinjve: Një prioritet i politikës për rimëkëmbjen ekonomike të Ballkanit Perëndimor, <https://esthinktank.com/2022/01/10/youth-entrepreneurship-a-policy-priority-for-western-balkan-economic-recovery/>, Aksesuar: Nëntor 2022.

1.2 Grupi i autorëve, 2021., Mbështetja e sipërmarrjes sociale të të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Evropë, <https://www.diesis.coop/wp-content/uploads/2021/07/WB-SEA-Supporting-Youth-Social-Entrepreneurshipin-1.pdf>, Aksesuar: Nëntor 2022.



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- Dorëzimet 2.2 - Kurrikula për menaxhimin dhe matjen e impaktit

Pse u zgjodhën këto tema Kurrikule?

Si fillim, studime të shumta² tregojnë se mundësuesve/zhvilluesve dhe mbështetësve të sipërmarrjeve sociale, përfshirë WISE-të, shpesh u mungojnë aftësitë menaxhuese dhe sipërmarrëse. Kurrikula e parë për menaxhimin e sipërmarrjeve sociale dhe WISE-ve është projektuar për të ofruar aftësi bazë dhe të përgjithshme, si dhe njohuri për sipërmarrësit socialë që bëhen pjesë e kësaj fushe. Megjithatë ky dokument nuk është mjaftueshëm gjithëpërfshirës që të sigurojë sukses ose të garantojë njohuri të plota të kërkesave specifike të vendit me të cilat mund të përballen sipërmarrësit. Objektivi i tij është pajisja e sipërmarrësve të ardhshëm me aftësitë e nevojshme për të filluar sipërmarrjen e tyre.

Megjithatë të qenit i aftë nuk mjafton për të menaxhuar me sukses një sipërmarrje. Gjithashtu është e nevojshme përmirësimi dhe prezantimi i punës dhe vlerave të krijuara. Menaxhimi dhe matja e impaktit mund të vijnë në ndihmë në krijimin e përmirësimeve dhe prezantimin tek aktorët e interesit. Pavarësisht nevojës në rritje për aftësi menaxheriale/sipërmarrëse, ekziston gjithashtu nevoja për të matur dhe menaxhuar impaktin social të sipërmarrjeve (sociale). Avantazhet e matjes dhe menaxhimit të impaktit social janë të shumta, si: prezantimi kuptimplotë i punës së organizatës/sipërmarrjeve dhe prezantimi i qartë i vlerës së krijuar, vizibilitet dhe legjitimitet më i madh i organizatës, baza për advokimin cilësor me vendimmarrësit dhe investitorët, e shumë të tjera. Kurrikula e dytë, Kurrikula për menaxhimin dhe matjen e impaktit, është projektuar për të zgjeruar njohuritë SIMM (Matja dhe menaxhimi i impaktit social) të pjesëmarrësve në temën e caktuar dhe për të dëgjuar/ndarë përvojat e tyre në mënyrë që ata të mund ta zbatojnë atë praktikisht, duke krijuar një model SIMM për të demonstruar shembullin e tyre (organizatë, sipërmarrje, projekt, program...). Kërkime të shumta, artikuj, tendenca dhe madje edhe rregullore “imponojnë” çështjen e matjes dhe menaxhimit të ndikimit social si një nga konceptet kryesore në të ardhmen.³

2

2.1 Grupi i autorëve / Projekti B-WISE, 2022., Raport mbi tendencat dhe sfidat për sipërmarrjet sociale të integritit në punë (WISE-të) në Evropë, https://www.bwiseproject.eu/Portals/bewise/OpenContent/Files/1130/B-wise_WP1_Research_Report-1.pdf, Aksesuar: Nëntor 2022.

3

3.1 Grupi i autorëve / Projekti SIM4CSO, 2021., Raport gjithëpërfshirës - Praktikrat dhe nevojat më të mira në lidhje me Matjen e Ndikimit Social në OSHC, <https://measuringimpact.eu/wp-content/uploads/2022/09/SIM4CSOs-IO1-Comprehensive-.pdf>, Aksesuar: Nëntor 2022.

3.2 Leonora Buckland dhe Lisa Hehenberger, 2021., Matja e ndikimit social mund të ndihmojë në nxitjen e një ekonomie sociale më të fortë evropiane, https://ssir.org/articles/entry/measuring_social_impact_can_help_foster_a_stronger_european_social_economy, Aksesuar: Nëntor 2022.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Së fundi, qëllimi i Kurrikulave është të paraqesë materialin (teorik dhe praktik) dhe të përcaktojë përmbajtjen e trajnimit që do të mundësoj përfaqësuesit e partnerëve të projektit të jenë trajnerë për temat e menaxhimit të sipërmarrjeve sociale/WISE-ve dhe të SIMM (Matja dhe menaxhimi i impaktit social) për përdoruesit e drejtpërdrejtë (me synim përfaqësuesit e rinj të WISE-ve) në vendet e tyre, në mënyrë që të jenë gati dhe të përgatitur si mundësuesit, zhvilluesit dhe mbështetësit e sipërmarrjeve WISE.

III. Aspektet teknike të zhvillimit të Kurrikulave

Krijimi i Kurrikulës dhe i këtij raporti është pjesë e aktivitetit në Paketën e Punës 2 (WP2): Koncepti i moduleve të trajnimit.

Sipas aplikimit për projektin, partneri kryesor përgjegjës për WP2 është ACT Group (AG). Partnerët (AG, SENT) të cilët janë përgjegjës për krijimin e Kurrikulave janë përzgjedhur sipas ekspertizës dhe përvojës së tyre në lidhje me temat e Kurrikulave.

3.3 Këshilli i BE-së, 2022., Rregulla të reja për raportimin e qëndrueshmërisë së korporatave: marrëveshje e përkohshme politike midis Këshillit dhe Parlamentit Evropian, <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2022/06/21/new-rules-on-sustainability-disclosure-provisional-agreement-mes-council-and-european-parlament/>, Aksesuar: Nëntor 2022.

3.4 Rrjeti i Investimit të Ndikimit Global - Dean Hand, Ben Ringel dhe Alexander Danel, 2022., GIINSight: Përmasat e Tregut të Investimeve të Impaktit 2022, <https://thegiin.org/research/publication/impact-investing-market-size-2022/>, Aksesuar: Nëntor 2022.

3.5 Irene Bengo, Leonardo Boni, Alessandro Sancino, 2022., Rregulloret financiare të BE-së dhe praktikrat e matjes së impaktit social: Një kuadër gjithëpërfshirës mbi financat për zhvillim të qëndrueshëm, <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1002/csr.2235>, Aksesuar: Nëntor 2022.



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Tabela e mëposhtme paraqet pikat kryesore dhe përmbledhjen e WP2:

Dorëzimi nr.	Emri i dorëzimit	Përfituesi kryesor	Lloji	Niveli i shpërndarjes	Afati fundit për dorëzimin e dokumentave (muaj)	Përshkrimi
D.2.1	Kurrikula (për trajnimin e partnerëve) për menaxhimin e sipërmarrjeve sociale dhe WISE-ve	SENT	Dokument	Publik	6 shtator 2022.	Digjital Anglisht 5 faqe
D.2.2	Kurrikula për menaxhimin dhe matjen e impaktit	AG	Dokument	Publik	7 tetor 2022.	Digjital Anglisht 5 faqe
D.2.3	Raport mbi zhvillimin e moduleve të trajnimit	AG	Raport	Publik	8 nëntor 2022.	Digjital Anglisht, Serbisht, Kroatisht, Sllovenisht, Shqip dhe Maqedonisht 15 faqe

Për krijimin e Kurrikulave (dhe materialeve shoqëruese) u ra dakord për fazat e mëposhtme të **procesit të bashkë-krijimit**:

Fillimi / Qershor 2022.

- Hartimi i përjasjes/metodologjisë dhe strukturës së parë të Kurrikulave / AG dhe SENT
- Ndarja e strukturës së Kurrikulave dhe draftit të përmbajtjes me ENSIE / AG, SENT, ENSIE
- Përditësimi i Kurrikulave (strukturës dhe përmbajtjes) në bazë të komenteve të para / AG, SENT
- Prezantimi dhe ndarja e Kurrikulave me të gjithë partnerët për rishikim/komentim / Të gjithë partnerët e projektit



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

5. Finalizimi i Kurrikulave dhe i materialeve – dorëzimi i Kurrikulave

Fundi / Tetor 2022.

Si më poshtë aktivitetet/takimet kryesore të zhvilluara:

1. 13 maj 2022. / Takimi online i fillimit të projektit, të gjithë partnerët pjesëmarrës

- prezantim i përmbledhur i të gjithë projektit, duke përfshirë WP2
- përcaktimi i afateve të fundit për dorëzimet dhe diskutim mbi çështje/pyetje të mundshme rreth Kurrikulave
- dakordësim mbi hapat e mëtejshëm (me partnerët kryesorë) në zhvillimin e WP2 - faza përgatitore

2. 7 qershor 2022. / Takimi online, SENT, AG

- Diskutim i qasjes së WP2 me SENT

3. 4 korrik 2022. / Takimi online, SENT, AG, ENSIE

- diskutim mbi strukturën dhe përmbajtjen e Kurrikulave
- përcaktim i hapave të ardhshëm dhe afatit për hartimin e parë të Kurrikulave

4. 17 gusht 2022. / Takimi online, SENT, AG, ENSIE

- në takim, SENT, AG dhe ENSIE kontrolluan Kurrikulat e hartuara
- u ra dakord për elementët shtesë që duhen bërë në Kurrikula dhe afatet brenda të cilave duhet të përgatiten versionet e plota për t'i dërguar/paraqitur ato te partnerët e tjerë të projektit për rishikim dhe koment.

5. 9 shtator 2022. / Takimi online, të gjithë partnerët

- të dy SENT (Gregor) dhe AG (Darko) prezantuan Kurrikulat e krijuara: SENT në lidhje me Kurrikulën (për trajnimin e partnerëve) për menaxhimin e sipërmarrjeve sociale dhe WISE-ve (D.2.1) dhe AG në lidhje me Kurrikulën për menaxhimin dhe matjen e impaktit (D.2.2)
- u diskutua mbi çështje/pyetje të mundshme rreth Kurrikulave dhe u mbledhën komentet fillestare nga partnerët

Partnerëve të projektit iu ofrua mundësia të komentojnë rreth versionit përfundimtar të Kurrikulës deri në fund të shtatorit. Pas kësaj u dorëzuan versionet finale të Kurrikulave.



Co-funded by
the European Union




Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Vlen të theksohet se krijimi i Kurrikulës u zhvillua në një proces bashkë-krijues - partnerët përgjegjës për zbatimin e WP2 krijuan strukturën bazë dhe draftin e përmbajtjes, ndërsa partnerët e tjerë u përfshinë duke dhënë komente dhe sugjerime për shtesa/ndryshime të mundshme. Koordinimi dhe komunikimi rreth krijimit të Kurrikulës u zhvillua në një mjedis online - nëpërmjet e-mail, takimeve online dhe mjeteve të bashkëpunimit (Office 365, MS SharePoint...).

Një ndarje e tillë e dakordësuar mes roleve (partnerët përgjegjës- ngritja e strukturës dhe përmbajtjes bazë, partnerët e tjerë - rishikimi dhe komentimi/sugjerimet) dhe përdorimi i mjedisit online (mjetet digjitale) ndihmuan në kryerjen e aktivitete brenda afateve të përcaktuara nga projekti.

Bashkëngjitur/dëshmi të takimeve:

7 qershor 2022. / Takimi online, SENT, AG



4 korrik 2022. / Takimi online, SENT, AG, ENSIE





Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

9 shtator 2022. / Takimi online, të gjithë partnerët



KoM WISEs4Youth


Agenda

9th of September, 10h – 12h30 CEST

Online - Teams

Time	Topic	Partner
10h00	Join Teams	
10h05	Welcome! Introduction of the agenda + Aziza re-introduction as coordinator project	ENSE
10h20	WP 1: quality assurance plan: questions? – qualitative elements per partners – needs to be approved: individual conversations	ENSE
10h45	WP 2: presentation SENT and AG of curricula	SENT & AG
11h05	Feedback partners on WP 2 + internal deadlines	All partners
11h30	Communication documents: PBo + questions	ENSE
11h35	5 minute break	
12h00	Timing training modules and SV (what partner, when): decide on exact dates, general debate on overview events	All partners
12h15	Looking forward: January 2023 + next transnational project meeting	ENSE
12h25	Looking forward: implementation training module young people – how to reach them?	ENSE
12h30	AOB & questions	All partners

Struktura e dosjes WP2 të projektit në SharePoint





IV. Aspektet e përmbajtjes të zhvillimit të Kurrikulave

Siç u përmend më lart, këto dy Kurrikula, bashkë me materialet shoqëruese, përfaqësojnë metodologjinë dhe mjetet për zbatimin e trajnimit 5-ditor (Trajnim 3 ditor - Menaxhimi + Trajnimi 2-ditor SIMM).

A. Struktura e Kurrikulave

Së pari, sipas përcaktimeve në aplikimin për projektin, komenteve fillestare të partnerit kryesor dhe marrëveshjes ndërmjet partnerëve që ishin përgjegjës për krijimin e Kurrikulave (AG, SENT), u ra dakord për strukturën e mëposhtme të të dy Kurrikulave:

- **Hyrje / përshkrim i shkurtër i Kurrikulës** – informacion bazë për Kurrikulën dhe arsyen e hartimit të saj
- **Qëllimet / Objektivat** – qëllimi i Kurrikulës dhe çfarë synohet të arrihet me pjesëmarrësit dhe cilat pyetjeve synohen t'u japim përgjigje
- **Pjesëmarrësit** – informacion për pjesëmarrësit e dëshiruar (numri) për trajnim bazuar te Kurrikula
- **Kompetencat** – informacion mbi kompetencat e rekomanduara/të kërkuara të pjesëmarrësve në trajnim dhe lektorëve
- **Përmbajtja** – përmbledhja bazë ditë për ditë e temave të trajtuara në trajnim
- **Kohëzgjatja** – informacion për kohëzgjatjen totale/për ditë të trajnimit
- **Metodologjia / Strategjitë e trajnimit** – informacion rreth qasjes së përdorur për trajnim
- **Materialet e Trajnimit (vetëm në D.2.2)** – përshkruajnë shkurtimisht disa karakteristika të materialeve dhe qasjeve që do të përdoren
- **Përshkrimi** – një kornizë kohore më e detajuar për çdo ditë dhe një përmbledhje e temave të mbuluara në ditët e trajnimit

Pas përcaktimit dhe konfirmimit të strukturës së Kurrikulave, AG dhe SENT filluan të punojnë në mënyrë më të detajuar.

Të dyja Kurrikulat janë përgatitur në gjuhën angleze në të paktën 5 faqe (siç përcaktohet në aplikimin e projektit) dhe ndjekin strukturën e lartpërmendur.



Tabela e mëposhtme tregon karakteristikat themelore dhe ndryshimet të secilës Kurrikul:

Kurrikula	Kurrikula (për trajnimin e partnerëve) për menaxhimin e sipërmarrjeve sociale dhe WISE-ve	Kurrikula për menaxhimin dhe matjen e impaktit
Kohëzgjatja	Trajnim 3 ditor 6 orë punë efektive në ditë	Trajnim 2 ditor 6 orë punë efektive në ditë
Pjesëmarrësit	25 pjesëmarrës nga grupet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> Në mënyrë direkte: Përfaqësuesit nga partnerët e projektit – Trajnerët që do të zhvillojnë trajnime për menaxhimin në vendet partnere Në mënyrë indirekte: Përfaqësuesit e WISE-ve – Të rinj që kanë rolin mundësues/zhvillues ose mbështetës në WISE-t dhe do të marrin pjesë në trajnimin për menaxhimin e sipërmarrjeve sociale. 	25 pjesëmarrës nga grupet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> Në mënyrë direkte: Përfaqësuesit nga partnerët e projektit – Trajnerët që do të zhvillojnë trajnime për SIMM në vendet partnere Në mënyrë indirekte: Përfaqësuesit e WISE-ve – Të rinj që kanë rolin mundësues ose mbështetës në WISE-t dhe do të marrin pjesë në trajnimin SIMM
Përmbajtja	<p style="text-align: center;">Dita e parë</p> <ul style="list-style-type: none"> Sipërmarrja sociale kundrejt sipërmarrjes klasike Përfshirja e grupeve vunerabël <p style="text-align: center;">Dita e dytë</p> <ul style="list-style-type: none"> Aftësi biznesi: Tregu dhe pjesa që përfaqëson sipërmarrja sociale në treg. <p style="text-align: center;">Dita e tretë</p> <ul style="list-style-type: none"> Aftësi biznesi: Edukimi financiar 	<p style="text-align: center;">Dita e parë</p> <ul style="list-style-type: none"> Hyrja dhe prezantimi i qëllimit të trajnimit Qëllimi, konteksti dhe koncepti i SIMM, cikli SIMM Logjika bazë SIMM - Krijimi i vlerës Parimet kryesore të SIMM Çështjet dhe sfidat kryesore të SIMM Tendencat, qasjet dhe mjetet SIMM <i>Pyetje të hapura dhe mbyllja e ditës së parë</i>



		<p style="text-align: center;">Dita e dytë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapat kryesorë në zhvillimin e strukturës/ modelit SIMM për secilën nga sipërmarrjet sociale • Punë praktike (Teoria në praktikë) <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i modelit SIMM dhe planit të zbatimit • Pyetje të hapura - tematike (në lidhje me SIMM) dhe teknike (zbatimi i trajnimit me përfaqësuesit e WISE) • <i>Mbyllja e trajnimit</i>
--	--	--

B. Përmbajtja / objektivat

Siç vërehet nga tabela, 2 Kurrikulat përfaqësojnë bazën për realizimin e trajnimit që zgjat 5 ditë në total. Trajnimi ndahet në dy pjesë (secila bazohet në një Kurrikul të veçantë) si më poshtë:

Pjesa e parë – trajnim tre (3) ditor mbi menaxhimin e sipërmarrjeve sociale dhe WISE-ve me objektivat e mëposhtme:

1. Sipërmarrja sociale kundrejt sipërmarrjes klasike - Mësoni rreth ndryshimeve mes asaj se çfarë është dhe çfarë bën një sipërmarrje sociale dhe si ndryshon nga një sipërmarrje "klasike", jo sociale.
2. Përfshirja e grupeve vunerabël- Informohuni për rëndësinë e punësimit të grupeve vunerabël.
3. Aftësi biznesi – tregu dhe pjesa që përfaqëson sipërmarrja sociale në treg: Kuptoni se si të krijoni një WISE në praktikë. Shqyrtoni tregun për WISE-të dhe shikoni se si e prezantojnë dhe promovojnë veten në treg sipërmarrjet sociale ekzistuese.
4. Aftësi biznesi - Edukimi financiar: Përvetësoni bazat e edukimit financiar të biznesit.

Pjesa e dytë – trajnim dy (2) ditor për menaxhimin dhe matjen e ndikimit me objektivat e mëposhtme:

1. Kuptoni se çfarë është Matja dhe Menaxhimi i Impaktit (Social) (SIMM).



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

2. Njihni përfitimet, mundësitë dhe sfidat e zbatimit të SIMM në mjedisin tuaj (dhe WISE)
3. Njihuni me qasje/metodologji/mjete të reja
4. Zhvilloni një model SIMM dhe zbatojeni atë në mjedisin tuaj - matni rezultatet dhe ndikimin social/mjedisor
5. Përgatituni të ndani njohuritë e fituara me të tjerët

Përshkrimi i detajuar dhe përmbajtja ditore është përfshirë në Kurrikulat dhe materialet/prezantimet përkatëse për trajnimin që tashmë janë zhvilluar.

C. Parimet e përgjithshme të trajnimit

Hartimi i Kurrikulave nuk merr në konsideratë vetëm aspektet e përmbajtjes që duhet t'u prezantohet pjesëmarrësve, por konsideron edhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Kurrikulat janë hartuar me në fokus partnerët e projektit. Pas pjesëmarrjes dhe përfundimit të trajnimit të zhvilluar sipas Kurrikulave të përgatitura, partnerët duhet të kenë përvetësuar teorinë dhe njohuritë praktike për t'i prezantuar dhe transferuar ato tek përfaqësuesit e WISE, në mjedisin/organizatat/vendet e tyre specifike.

Duke marrë parasysh komentet dhe opinionet e partnerëve, janë përcaktuar parimet e përgjithshme të mëposhtme të cilat kanë udhëhequr procesin e krijimit të Kurrikulës për trajnim:

- niveli i vlerësuar i vështirësisë së temave (i përfaqësuar në trajnim dhe në materialet përkatëse) është në nivel fillestar deri në mesatar, si dhe përdorimi i gjuhës së thjeshtë (pa shumë shprehje teknike)
- trajnimi (dhe materialet) duhet të përbëhen nga teoria, por edhe pjesa praktike dhe shembuj të praktikës së mirë.
- trajnimi duhet të mbulojë tema të përgjithshme dhe të përshtatet me standardet e BE-së. Disa pjesë/materiale mund të përshtaten në mënyrë specifike sipas kontekstit kombëtar (kjo ndodh nën përgjegjësinë e secilit partner të projektit) dhe e bën Kurrikulën modulare.
- pjesëmarrja e të trajnuarve do të jetë e nevojshme gjatë trajnimit (5 ditë) dhe ata do të jenë në gjendje të përdorin materialet/mjetet e trajnimit pasi të ketë përfunduar trajnimi
- trajnimi duhet të përfshijë si punën individuale ashtu edhe atë në grup



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- trajnerët do të promovojnë aktivitete në të cilat të trajnuarit do të jenë në gjendje të bashkëveprojnë dhe të shkëmbejnë përvoja dhe njohuri - mjedis i sigurt, stimulues dhe aktiv i udhëhequr nga një trajner.

Megjithëse përmbajtja e draftit dhe objektivat e të mësuarit u përcaktuan sipas nevojave të identifikuar të grupit të synuar, përmbajtja u përshtat/rregullua paralelisht edhe me parimet dhe rreziqet e identifikuar (të përshkruara në kapitullin vijues). Një qasje e tillë paralele duhet të rezultojë në trajnime që, nga njëra anë, plotëson nevojat që lidhen me përmbajtjen, dhe nga ana tjetër, është mjaft praktike dhe e thjeshtë për t'u zbatuar pa rreziqe të tepërta.

Gjithashtu, nëse është e nevojshme, materialet e përgatitura për trajnim i nënshtrohen ndryshimeve të vogla deri në realizimin e trajnimit me përfituesit fundorë – përfaqësues të WISE-ve. Materialet mund të ndryshojnë bazuar në informacionin e mbledhur gjatë testimit pilot me përfaqësuesit e partnerëve të projektit (në fillim të vitit 2023) dhe vlerësimit të trajnimit.

D. Rreziqet e mundshme dhe masat zbutëse të trajnimit

Përveç parimeve të përmendura më parë që duhet të respektohen gjatë projektimit të Kurrikulës/trajnimit, partnerët identifikuan bashkërisht edhe rreziqet e mundshme që lidhen me zbatimin e Kurrikulës - zbatimi i trajnimit 5-ditor.

Tabela e mëposhtme tregon rreziqet e mundshme më të mëdha të identifikuar dhe masat e propozuara zbutëse:

RREZIKU	MASAT ZBUTËSE
5 ditë trajnimi radhazi është mjaft i vështirë dhe sfidues për pjesëmarrësit - për sa i përket motivimit por edhe kohës që ata mund të kursejnë për trajnim	<ul style="list-style-type: none"> - trajnimi duhet të sigurojë kohë të mjaftueshme të lirë për pjesëmarrësit dhe/ose të përfshijë disa përmbajtje të tjera argëtuese/studimore - trajnimi është i ndarë në dy pjesë - është e mundur të mbahet trajnimi sipas modelit: Pjesa e parë 3-ditore



	/ një pushim prej disa ditësh / pjesa e dytë 2-ditore
Rekrutimi i pjesëmarrësve të trajnimit (përfaqësuesit e WISE)	<ul style="list-style-type: none"> - secila organizatë duhet së pari të kontrollojë në portofolin e saj nëse ka pjesëmarrës të mundshëm me të cilët ka punuar tashmë - nëse është e nevojshme, duhet të krijohet partneritet me organizata të tjera për të marrë rekomandimet e kandidatëve
Niveli shumë i ndryshëm i njohurive dhe nevojave të pjesëmarrësve	<ul style="list-style-type: none"> - niveli i vlerësuar i objektit (i përfaqësuar në trajnim dhe materialet përkatëse) është në nivel fillestar deri në mesatar - pyetëtori paraprak këshillohet për të kontrolluar nivelin e njohurive dhe nevojës
Specifikat e çdo vendi (të cilat duhet të merren parasysh)	<ul style="list-style-type: none"> - trajnimi është projektuar në mënyrë modulare që pjesë të caktuara të trajnimit/materialit të mund të përshtaten me specifikat e çdo vendi (kjo ndodh nën përgjegjësinë e secilit partner)

Për të shmangur rreziqet shtesë të shkaktuara nga specifikat e secilit vend, partnerët e projektit janë në gjendje të rregullojnë procesin e zbatimit të trajnimit në një masë më të vogël sipas nevojës (p.sh. procesin e rekrutimit/përzgjedhjes së pjesëmarrësve, pjesë të veçanta të materialit, etj.)



V. Analiza dhe vlerësimi i cilësisë së Kurrikulave

Analiza dhe vlerësimi i cilësisë së Kurrikulave është përcaktuar dhe përfshirë në seksionin e veçantë të dokumentit të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit të Brendshëm të projektit. Analiza dhe vlerësimi i cilësisë së WP2 dhe Kurrikulave do të bëhet në 2 nivele:

Matja sasiore:

Njësia e matjes dhe baza: krijimi i 2 moduleve të trajnimit, përsëritja dhe zbatueshmëria për grupin e synuar.

Vlerat e synuara: Të paktën dy module trajnimi në 5 vende partnere për trajnim të ofruara për një total prej 10 modulesh trajnimi të përsëritura.

Matja cilësore:

Moduli i parë i trajnimit: Moduli i trajnimit duhet të mbulojë të gjitha aspektet e rëndësishme të zhvillimit të aftësive për të rinjtë që udhëheqin SE dhe/ose WISE, që nënkupton ndryshimin mes sipërmarrjes së rregullt dhe asaj sociale, përfshirjes së grupeve të cenueshme, aftësive të biznesit dhe edukimit financiar. Trajnimi duhet t'i kushtojë vëmendje të mjaftueshme aspekteve më teknike që kanë lidhje me menaxhimin financiar.

Moduli i dytë i trajnimit: Moduli i dytë i trajnimit do të zhvillohet nga partnerë me përvojë në matjen dhe menaxhimin e ndikimit social. Njohuritë e mbledhura më parë dhe përvoja praktike do të grumbullohen në modulin e trajnimit gjithëpërfshirës. Mjete konkrete duhet të përfshihen për të kryer matjen e ndikimit social.

Një koordinim i mjaftueshëm duhet të sigurohet ndërmjet partnerëve (T2.2): AG do të organizojë një takim me të gjithë partnerët për të mbledhur nevojat specifike në kohë që kanë lidhje me përmbajtjen. Për më tepër, çdo rezultat duhet të ndahet me të gjithë partnerët në kohë, që do të thotë se partnerët e projektit kanë të paktën dy javë për të kontrolluar dokumentet përpara afatit të brendshëm.

Cilësia dhe qartësia e konceptit të moduleve të trajnimit (siç është vlerësuar nga të gjithë partnerët). Të gjithë partnerët duhet të japin miratimin e tyre për 1) përmbajtjen e Kurrikulave, 2) qartësinë dhe 3) mundësinë e zbatimit të tyre. Tashmë është bërë miratimi i Kurrikulave dhe do të kemi një vlerësim shtesë pasi të testojmë Kurrikulën përmes trajnimit pilot (të planifikuar për muajin e parë të 2023) me përfaqësuesit e partnerëve.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Në lidhje me zbatimin pilot, analiza dhe vlerësimi i cilësisë do të përfshihen gjithashtu në dokumentet e mëposhtme të paketës së punës WP 4 Trajnimi dhe zbatimi:

- Dorëzimet 4.1 Pyetësi mbi përmbushjen
- Dorëzimet 4.2 Raporti mbi përfundimin e trajnimit
- Dorëzimet 4.3 Raporti përfundimtar mbi trajnimin

Asnjë stigmatizim dhe profilizim etnik, gjinor në asnjë aktivitet; fokusi është tek shumëllojshmëria e të rinjve.

Pyetëtorët e komenteve do të ndahen në fund të çdo aktiviteti, aktiviteti trajnues dhe vizite studimore të organizuar.

Komentet mbi Kurrikulat janë mbledhur nga partnerët dhe në bazë të tyre, ky Raport është hartuar dhe përkthyer në gjuhët e partnerëve (anglisht, serbisht, kroatisht, sllovenisht, shqip dhe maqedonisht).

VI. Hapat e ardhshëm në zhvillimin/zbatimin e Kurrikulave

Pas zhvillimit të Kurrikulave dhe materialeve, këtu paraqiten hapat e planifikuar që duhen ndjekur dhe përmes të cilëve Kurrikulat do të diskutohen dhe zhvillohen më tej:

1. Përpunim i mundshëm i vogël i materialit të trajnimit përpara testimit pilot (deri në fund të vitit 2022.)
2. Marrëveshjet dhe përgatitjet për testimin pilot të trajnimit me përfaqësuesit e partnerëve të projektit (deri në fund të 2022.)
3. Testimi pilot dhe vlerësimi si dhe përsosja e Kurrikulave dhe materialeve (planifikuar për janar 2023.)
4. Zbatimi dhe vlerësimi i Kurrikulave në çdo vend nga partnerët e projektit (deri në fund të prillit)
5. Përfundimi i Kurrikulave dhe materialeve të trajnimit bazuar në vlerësimet në çdo vend (deri në fund të majit.)



VII. Të mësuarit nga procesi i zhvillimit të Kurrikulave

Nëpërmjet zhvillimit të Kurrikulës, ne kemi mbledhur/konfirmuar disa pika mësimore që duhen theksuar:

- për hir të praktikitetit dhe funksionalitetit të proceseve të tilla të zhvillimit të Kurrikulës (materiale, botime, etj.), është praktike që ekipi kryesor (ekspert) të përgatisë strukturën dhe të paktën versionin e parë të materialit, të cilat më pas i nënshtrohen komenteve dhe ndryshimeve nga të gjithë partnerët
- gjithashtu, përdorimi i teknologjive digjitale kontribuon në funksionalitetin dhe praktikitetin
- temat duhet të trajtohen teorikisht (të qarta dhe koncize, leksione/prezantime jo shumë të gjata) dhe praktikisht (shumë shembuj të mirë, ushtrime praktike, punë në grup, reflektime personale, shkëmbim njohurish/përvoja, nxjerrje në pah të pikave mësimore...) dhe temat praktike duhet të jenë në të njëjtin nivel ose edhe më mirë se ato teorike
- qasja paralele e të menduarit përpara - zhvillimi i Kurrikulës dhe materialeve paralelisht me reflektimin mbi zbatimin në aspektin e kuadrit dhe faktorëve por edhe vetë trajnimit
- lind nevoja të lihet pak hapësirë për specifikat e çdo vendi